



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit**  
**Ministarstvo Ekonomije i Zivotne Sredine/Ministry of Economy and Environment**

**AGJENCIA E KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË**  
**KOSOVSKA AGENCIJA ZA EFIKASNOST I ENERGIJU**  
**KOSOVO ENERGY EFFICIENCY AGENCY**

---

## **Thirrje për Aplikim**

Titulli i Aplikacionit: **Thirrja për Aplikim për grante në projektin për zbatimin e masave për EE në sektorin privat**

Numëri referent i thirrjes për aplikim: **01/2021**

Lëshuar më: **08 shkurt 2021**

### **Hyrje**

Efiçienca e Energjisë (EE) konsiderohet nga Qeveria e Kosovës një komponentë thelbësore e planifikimit strategjik dhe ekonomik si dhe për zhvillimin e vendit, prandaj Kosova është përcaktuar që të kontribuojë drejt arritjes së caqeve për EE, duke krijuar për qytetarët stimuj në kursimin e energjisë, por edhe për tregjet e hapura dhe aplikimin e bizneseve të reja për EE teknologjitë.

Si Palë Nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE) dhe e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), Kosova është obliguar që ta transpozojë dhe zbatojë rregullativën e Bashkësisë Evropiane që ndërlidhet me Efiçiençën e Energjisë. Republika e Kosovës dhe institucionet e saj përgjegjëse në fushën e EE kanë shprehë vullnetin e tyre drejt përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë.

Në drejtim të krijimit të kornizës adekuate ligjore Kosova ka bërë një progres të konsiderueshëm, duke miratuar ligjet (Ligji nr. 05/L-101 për Performancën Energjetike në Ndërtesa dhe Ligji nr. 06/L-079 për Efiçiençë të Energjisë), si dhe legjislacionin sekondar që ndërlidhet me detyrimet nga TKE dhe MSA. Sidoqoftë, mbetin shumë sfida që dalin nga sa u tha më lartë. Në vendin tonë ka pasur përparim të madh në zbatimin e masave EE në sektorin publik, por ende mbetin sfida të tjera që do të adresohen gjatë viteve në vijim, sidomos përmes PKEK 2021-2030.

Sektori privat dhe amvisërisë paraqet një sfidë të madhe, të cilit duhet t'i qasemi me kujdes të veçantë, përmes shfrytëzimit të potencialit vendor, duke mësuar nga përvojat e shteteve me karakteristika dhe vështirësi të ngjashme, qoftë në rajon apo vendet e kontinentit Evropian. Për ta mbështetur këtë sektor, Agjencia e Kosovës për Efiçiençë të Energjisë (AKEE) ka

planifikuar shpërndarjen e subvencioneve për bizneset private, sipas kriterëve të përshkuara në kapitujt e mëposhtëm.

## **Thirrje publike**

Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), do ta bëjë përkrahjen e sektorit privat për **Zbatimin e masave të Eficiencës së Energjisë në Instalimin e teknologjive te reja qe kursejnë energji elektrike ne sektorin privat.**

Qëllimi i këtij projekti është mundësia e qasjes së kontributit nga sektori privat në arritjen e plotësisimit të caqeve për EE në Kosovë, që rrjedhin nga obligimet që vendi ynë ka marrë karshi BEs. Objektivi specifik është që subvencionet të cilat janë planifikuar nga AKEE në përkrahje të këtij sektori shumë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës, do të ndikojnë në ngritjen e vetëdijes te sektori privat për mundësitë e kursimit të energjisë, përdorimin e teknologjive moderne me EE të lartë dhe Energjinë e Ripërtëritshme, si dhe rritjen e nivelit të komfortit. Gjithashtu, do të ngritën kapacitetet e akterëve të përshirë në këtë projekt: bizneset, prodhuesit vendor, ekspertët, instaluesit dhe institucionet qeveritare pjesëmarrëse.

Një objektivi tjetër i këtij projekti është edhe kontributi në rimëkëmbjen ekonomike të vendit, pas ndikimit të pandemisë, sipas ligjit Nr. 07/L-016 për rimëkëmbjen ekonomike - COVID-19.

Vlera e përgjithshme financiare e paraparë për këto subvencione është **1 milion Euro.**

## FORMULARI I APLIKIMIT

Data: \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_

(Të plotësohet nga aplikuesi)

| <b>I. INFORMATAT E PËRGJITHSHMË TË APLIKUESIT</b>   |  |
|---|--|
| 1. Emri dhe Mbiemri   |  |
| 2. Numri personal   |  |
| 3. Data e lindjes   |  |
| 4. Vendbanimi (Komuna)  |  |
| 5. Nacionaliteti  |  |
| 6. Gjinia   |  |
| 7. Profesioni   |  |
| 8. Nr. i telefonit  |  |
| 9. E-mail adresa  |  |
| 10. Emri i biznesit   |  |
| 11. Numri i biznesit  |  |
| 12. Data e regjistrimit   |  |
| 13. Lloji i biznesit (Përgjegjësi e kufizuar, Biznes individual, Ortakëri)                      |  |
| 14. Emri (at) i pronarit (ët) të biznesit   |  |
| 15. Adresa e plotë e biznesit   |  |
| 16. Emri (t) e përfaqësuesve të autorizuar të biznesit  |  |
| 17. Informata se në çfarë sektori vepron biznesi juaj (p.sh. prodhim, industri e shërbimit etj) |  |

## Kriteret e vlerësimit

Shuma e përgjithshme financiare e projekteve të planifikuara nga bizneset vendore, në këtë rast instalimi i teknologjive të reja që kursejnë energji elektrike minimum 50%, ndriçimit të jashtëm dhe/ose të brendshëm, është planifikuar të jetë rreth 5,000 – 100,000.00 Euro, ndërsa vlera e subvencioneve nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit/Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë do të jete në përqindje prej 70% të vlerës së përgjithshme të projektit ndërsa, përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët (ndërmarrja) duhet të jetë 30% të vlerës së përgjithshme të projektit.

Shpenzimet për Raportin e Auditimit të energjisë mbulohen nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit/Agjencisë të Kosovës për Eficiencë të Energjisë të cilat janë 5% të vlerës së projektit.

Kriteret për kompanitë e interesuara për subvencione, që duhet dorëzuar në AKEE, janë listuar më poshtë:

| <b>Kriteret e përzgjedhjes</b>   | <b>Poentimi (%)</b> |
|--|---------------------|
| Hartimi i një koncepti të shkurtër së bashku me planin dinamik dhe metodologjinë e zbatimit të projektit (rreth 2 – 3 faqe).   | 1-10                |
| Raporti i auditimit energjetik nga një auditor i energjisë i certifikuar me standardin EN 16247 / inxhinier i elektroteknikës i certifikuar sipas “Rregullores (MEPTINIS ) Nr. 05/2020”. Raporti duhet të përfshijë edhe specifikacionin teknik, bazuar në kërkesat e veçanta të AKEE-s. | 1-30                |
| Përmbushja e kriterëve të produkteve të ofruara, që janë përcaktuar nga AKEE në Terma të Referencës.   | 1-30                |
| Te prezantohet potenciali i kursimit të energjisë elektrike në kwh/vit dhe në euro/vite  | 1-20                |
| A është i kënaqshëm raporti ndërmjet kostos së vlerësuar dhe rezultateve të pritura?   | 1-10                |
| <b>Totali</b>  | <b>100</b>          |

Kriteret e produktit dhe raportimit specifikohen në Termat e Referencës (TeR).

Në rast që ndërmarrja (kompania/biznesi) do të jetë përfitues, atëherë do të nënshkruhet marrëveshja dypalëshe (AKEE dhe ndërmarrje), pjesë e secilës do të jenë edhe deklaratimet që janë bërë me rastin e aplikimit. Në marrëveshje specifikohet edhe mënyra e kompensimit nga AKEE për masat e zbatuara sipas kriterëve të përcaktuara.

Ndërmarrjet mund të përfitojnë vetëm një grant dhe atë vetëm për Instalimin e teknologjive të reja që kursejnë energji elektrike minimum 50%; Makineri, pajisje elektrike dhe trupa ndriçues të specifikuar në Terma të Referencës.

Vlerësimi i aplikacioneve zhvillohet ndërmjet kategorive përkatëse si mikro me mikro, të vogla me të vogla dhe të mesme me të mesme.

Bizneset që nuk i kalojnë 50 pikë nuk i përmbushin kriteret.

Përfitues do të jenë ato biznese që janë renditur më pikë më të larta nga komisioni vlerësues, varësisht prej limiteve buxhetore të planifikuara.

## **Vlerat e planifikuara financiare për subvencione**

MEA/AKEE do të mbështes me subvencione / mjete financiare ndërmarrjet sipas kategorive të tyre, mesa vijon:

Shuma e përgjithshme financiare e projekteve të planifikuara nga bizneset vendore, në këtë rast instalimi i teknologjive të reja që kursejnë energji elektrike minimum 50% dhe ndriçimit të jashtëm dhe/ose të brendshëm, është planifikuar të jetë rreth 5,000 – 100,000.00 Euro, ndërsa vlera e subvencioneve nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit/Agjencia e Kosovës për Efiçencë të Energjisë do të jete në përqindje prej 70% të vlerës së përgjithshme të projektit ndërsa, përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët (ndërmarrja) duhet të jetë 30% te vlerës së përgjithshme të projektit.

Shpenzimet për Raportin e Auditimit të energjisë mbulohen nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit/Agjencisë të Kosovës për Efiçencë të Energjisë të cilat janë 5% te vlerës së projektit.

**Sipas kësaj thirrje publike për financim (granti) do të përkrahen financiarisht aktivitetet e kualifikuara si më poshtë:**

- Auditimi i energjisë për teknologjinë që aplikon, vlerësimi financiar i shpenzimeve dhe propozimi para masave të efiçencës së energjisë.
- Demolimi i teknologjive të vjetra ekzistues si ; Makineri, pajisje elektrike, trupa ndriçues dhe vendosja e tyre në një vend të sigurt sipas standardeve.
- Zbatimi i masave të efiçencës së energjisë në teknologjitë të reja si; Makineri, pajisje elektrike dhe ndriçim të jashtëm dhe të brendshëm sipas specifikacionit teknik në Termat e Referencës.
- Matja e konsumit të energjisë para masave të EE dhe pas masave të EE ndërsa për ndriçim të behet matja me Luxmeter nga Auditori i energjisë dhe arritja e caktuar të paraparë sipas Termave të Referencës.

## **Kohëzgjatja e projektit për subvencione**

Perioda kohore që specifikohet në marrëveshje do të jetë maksimum gjashtë (6) muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes, sipas afateve kohore:

- a) Nënshkrimi i marrëveshjes me kompaninë/biznesin e përzgjedhur, pas plotësimit të kriterëve.
- b) Përfundimi i Projektit: brenda vitit fiskal pas nënshkrimit të marrëveshjes.

|  |       |
|--|-------|
| <b>Deklarata ne betim</b>  |       |
| Aplikuesi deklaron që të gjitha informatat në këtë aplikacion janë të vërteta dhe të plota, përfshirë çdo dokument të bashkangjitur, si dhe pranon detyrimin për të përmbushur kushtet e Thirrjes publike për financimin e bizneseve. <b>(Të plotësohet)</b> |       |
| Emri dhe mbiemri: _____  |       |
| Nënshkrimi:<br>Vula:   | Data: |

- Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike;
- Do të përkrahen vetëm kompanitë të cilat zbatojnë projektin në marrëveshje me përfituesin, që kanë në kuadër të tyre së paku një auditor të energjisë/inxhinier i elektroteknikes i çertifikuar sipas standardit EN 16247;
- Me qëllim të arritjes së objektivit të EE, do të përkrahen vetëm kompanitë të cilat zbatojnë projektin në marrëveshje me përfituesin, që i përmbahen specifikacionit teknik në Termat e Referencës;
- Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [akee@rks-gov.net](mailto:akee@rks-gov.net);
- Certifikata e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse;
- Dëshminë e xhirollogarisë aktive të aplikuesit në njërin nga Bankat e licencuara nga BQK;
- Aplikuesi duhet të dorëzojë vërtetimin tatimor të ATK-së.
- Të kenë të kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit nga Buxheti i Republikës së Kosovës në dy vitet e fundit
- Qarkullimi nga ATK për punëtorë dhe qarkullim financiar;
- Aplikuesi nuk duhet të ketë pranuar mjete financiare nga Buxheti i Republikës së Kosovës për realizimin e të njëjtave aktivitete në vitin përkatës fiskal;
- Shpallja e aplikacioneve: me procedurë të shkurtuar për shkak Covid-2019 – përfundon me datën **25/02/2021 në ora 16:00.**

#### **Periudha e aplikimit:**

Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në ueb-faqen e Agjencisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë: <https://akee.rks-gov.net/>. Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë sipas thirrjes publike duhet të shprehin interesimin e tyre duke dorëzuar në mënyrë elektronike të gjithë dokumentacionin në adresën elektronike [akee@rks-gov.net](mailto:akee@rks-gov.net).

## BUXHETI

| Formulari i Buxhetit   |                      |       |
|--|----------------------|-------|
| Ju lutemi tregoni kostot financiare të nevojshme për të përfunduar aktivitetet e planifikuara. (Ju mund të shtoni më shumë linja Aktivitete nëse është e nevojshme.) |                      |       |
| Linja buxhetore  | Përshkrim i detajuar | Shuma |
| Aktiviteti Nr.1  |                      | €     |
| Total Aktiviteti Nr.1  |                      | €     |
| Aktiviteti Nr.2  |                      | €     |
| Total Aktiviteti Nr.2  |                      | €     |
| Aktiviteti Nr.3  |                      | €     |
| Total Aktiviteti Nr.3  |                      | €     |
| Aktiviteti Nr.4  |                      | €     |
| Total Aktiviteti Nr.4  |                      | €     |
| <b>TOTAL</b>   |                      | €     |